



INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË

RAPORT SPECIAL NR. 12

mbi

dështimin e disa komunave në rindërtimin e shtëpive të shkatërruara në vitin 1999

drejtuar

Kuvendit të Kosovës

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit në Kosovë, në pajtim me nenin 16.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë dhe Rregullës 15, të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë, më **28 maj 2007**, ka publikuar raportin në vijim:

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

BAZAT PËR RAPORTIN

1. Ky Raport bazohet në ankesat e paraqitura në Institucionin e Ombudspersonit nga disa individë, pronat e të cilëve ishin regjistruar nga komunat e tyre si raste për rindërtim pas shkatërrimit të tyre në vitin 1999.

PRAPAVIJA E RAPORTIT

2. Që nga qershori i vitit 1999, Drejtoritë e Urbanizmit në shumë komuna kanë mbledhur fakte në lidhje me shtëpitë që ishin të shkatërruara gjatë luftës në vitin 1999. Komunat në fjalë janë:

Komuna e Deçanit
Komuna e Ferizajt
Komuna e Gjakovës
Komuna e Gjilanit
Komuna e Gllogocit
Komuna e Istogut
Komuna e Kaçanikut
Komuna e Kamenicës
Komuna e Klinës
Komuna e Lipjanit
Komuna e Malishevës
Komuna e Mitrovicës
Komuna e Pejës
Komuna e Podujevës
Komuna e Prishtinës
Komuna e Prizrenit
Komuna e Rahovecit
Komuna e Skenderajt
Komuna e Suharekës
Komuna e Vitisë
Komuna e Vushtrrisë

3. Në vitin 2000, 2001 dhe 2002, Drejtoritë e Urbanizmit regjistruan pronat e shkatërruara në komunat e lartpërmendura dhe i ndanë ato në kategori. Shtëpitë e dëmtuara më pak se 10% (dëmtime të lehta si dritaret e thyera) ishin në kategorinë e parë përderisa shtëpitë e shkatërruara në mes 10-20% (ato shtëpi me dëmtime të lehta si dritare dhe dyer të dëmtuara por pa djegie) ishin klasifikuar në kategorinë e dytë. Shtëpitë e dëmtuara në mes 20-60% (ato pjesërisht të djegura me kulme të paprekura) ishin në kategorinë e tretë dhe shtëpitë në mes 60-80% (ato shtëpi që ju kanë mbetur vetëm muret) ishin klasifikuar në kategorinë e katërt. Më në fund ishin shtëpitë që ishin plotësisht të shkatërruara, zakonisht nga zjarri ose eksplozivi, që bënin pjesë në kategorinë e pestë. Në atë kohë gjatë të ashtuquajturës “faza emergjente”, si kategori me theks parësor ishin shtëpitë e kategorive tre dhe katër – në të njëjtën kohë ato shtëpi që ishin vetëm pak të

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

dëmtuara (të kategorisë një dhe dy) ishin rinovuar sa më shpejt që ishte e mundur dhe ato që ishin plotësisht të shkatërruara kishin mbetur për tu rindërtuar më vonë.

4. Në gusht të vitit 2004, Departamenti për rindërtim i shtyllës së BE-së brenda Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) lëshoj një informatë për gjithë Kosovën, sipas së cilës 40,000 deri në 50,000 shtëpi të vlerësuara si tërësisht të shkatërruara nga numri i përgjithshëm i 120.000 shtëpive të shkatërruara, do të mbeten të pa banueshme deri në fund të vitit 2000. Programi i rindërtimit ishte zbatuar në atë mënyrë për të siguruar që përpjekjet e financuara në mënyrë private të mos anashkalohen. Viktimave të shtëpive të dëmtuara iu ishte thënë vazhdimisht edhe nga zyrtarët e UNMIK-ut edhe nga autoritetet komunale, që të mos mbështeten në bashkësinë ndërkombëtare për të rindërtuar shtëpitë e tyre nëse ata kanë mjete vetanake për t'i rindërtuar ato. Qëllimi në vitin 2000 nuk ishte që të rindërtohet çdo shtëpi e shkatërruar, por të sigurohet që çdo familje do të mund të strehohet. Prandaj, ndihma nuk ishte parashikuar për 40,000 deri 50,000 shtëpi të shkatërruara por për strehim, gjë që, në përfundim të vlerësimit të situatës, doli një numër shtesë prej 15,000 deri 20,000 i familjeve të cenueshme. Agjencioni Evropian për Rindërtim paraqiti Udhëzimet për Banim dhe Rindërtim në Kosovë: "Agjencioni kishte ndarë fonde për të ndihmuar rindërtimin e shtëpive në tërë Kosovën, në pajtim me standardet e caktuara në Udhëzimet e Departamentit për Rindërtim të UNMIK-ut. Mbi 50% e numrit të përgjithshëm të 8,000 shtëpive do të jenë të kategorisë plotësisht të shkatërruara. Kjo ishte hartuar për të caktuar një kornizë pune për rindërtim të shtëpive të dëmtuara dhe të shkatërruara. Administrata e UNMIK-ut dhe donatorët u pajtuan për përzgjedhjen e përbashkët të kritereve për përfitues, një proces i përbashkët i përzgjedhjes në nivelin komunal dhe nivelet e përbashkëta për ndihmë."
5. Gjatë viteve 2001, 2002 dhe 2003, rindërtimi i shtëpive vazhdoi, sidomos në rastet e familjeve të cenueshme ku ato nuk mundnin ti rindërtonin vetë, dhe në ato shtëpi ku dëmi mund të riparohej pa ndonjë mund të madh.
6. Nga fundi i vitit 2003, faza emergjente mbaroi dhe shumë programe rindërtimi u përqendruan në ndërtimin e shtëpive të reja për ti zëvendësuar ato që kanë qenë plotësisht të shkatërruara. Ende disa shtëpi të kategorisë së tretë, katërt dhe të pestë nuk ishin rindërtuara.
7. Gjatë viteve 2003 dhe 2005, shumë njerëz filluan të ankohen në Institucionin e Ombudspersonit, që shtëpitë e tyre në komunat në fjalë nuk ishin rindërtuar edhe pse Drejtoritë kompetente të urbanizmit iu kishin thënë se do të ndërtoheshin dhe se ishin të përfshirë në listat për rindërtime pas përfundimit të fazës emergjente. Përderisa BE-ja nuk kishte bërë ndonjë premtim më herët se do ti rindërtonin të gjitha shtëpitë e shkatërruara, një numër i madh i njerëzve kishin shkuar në komunat e tyre për tu interesuar për shtëpitë e tyre për rindërtim, dhe këto komuna kishin premtuar që do t'ua rindërtonin shtëpitë.

8. Gjatë viteve 2003 dhe 2007, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit e ngritën këtë çështje me komuna të ndryshme. Në shumicën e rasteve, autoritetet kompetente i informuan përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit se ata iu kishin thënë palëve, që kategori të caktuara të shtëpive të shkatërruara në vitet 1998-99 do të rindërtohen dhe deklaruan se kishin përgatitur lista me shtëpitë që kishin nevojë për rindërtim. Mirëpo, kur biseduan me përfaqësues të Institucionit të Ombudspersonit, zyrtarët komunal thanë që kjo varej prej fondeve të donatorëve, por nuk dhanë asnjë shembull të veprimeve të ndërmarra nga komunat për gjetjen e fondeve të tilla. Përgjashtim bënë vetëm komuna e Prizrenit e cila kishte ndarë një pjesë nga buxheti i saj për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara dhe të shkatërruara në këtë komunë.
9. Më 4 gusht 2005, ish-Ombudspersoni e ngriti çështjen e rindërtimit të shtëpive të lartpërmendura në letrën drejtuar Kryeministrit të Kosovës. Kopja e kësaj letre iu kishte drejtuar edhe Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm dhe Koordinatorit të UNMIK-ut për Standarde. Ombudspersoni kërkoi nga Qeveria e Kosovës të kyçet në çështjen e rindërtimit, duke pohuar se, pasi që autoritetet komunale kishin premtuar se do ti rindërtojnë shtëpitë e shkatërruara në vitin 1999, dhe sa i përket kësaj çështje, pronarët e këtyre shtëpive kanë të drejtë në pritje ligjore, në përputhje me nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (në tekstin e mëturshëm "Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut" ose "Konventa"), e cila mbron të drejtën në pronë.
10. Më 5 janar 2006, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër përkujtuuese Kryeministrit të Kosovës në të cilën kërkoi që qeveria të marrë një vendim në lidhje me çështjen e rindërtimit.
11. Më 16 shkurt 2006, Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit pranoi një përgjigje në letrën e datës 13 shkurt 2006 nga një zyrtarë i Zyrës së Kryeministrit, në të cilën zyrtari pohonte se autoritetet komunale ishin përgjegjëse për çështjen e rindërtimit.
12. Kah mesi i vitit 2006, një numër gjithnjë e më i madh i njerëzve, shtëpitë e të cilëve kishin qenë të shkatërruara në vitet 1998-99, filluan të dëbohen nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore e KB-së nga shtëpitë dhe banesat që ata i kishin uzurpuar pas përfundimit të luftimeve në vitin 1999.
13. Në fillim të vitit 2007, komunat e mëposhtme e informuan Institucionin e Ombudspersonit në lidhje me situatën e rindërtimit:

Komuna e Deçanit: Nuk ka të dhëna për numrin e përgjithshëm të shtëpive të dëmtuara dhe se sa shtëpi kanë qenë të rindërtuara.

Komuna e Ferizajt: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara: 1771; 650 nga këto shtëpi janë rindërtuar, 1121 shtëpi nuk janë rindërtuar.

Komuna e Gjakovës: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara: 5500; 4521 nga këto shtëpi janë rindërtuar, 970 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Gjilanit: Nuk ka të dhëna për numrin e përgjithshëm të shtëpive të dëmtuara, por 1165 shtëpi të dëmtuara nuk janë rindërtuar.

Komuna e Glllogocit: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara: 8537; nga këto janë rindërtuar 3997 ndërsa 4540 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Istogut: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara: 4586; 3327 nga këto janë rindërtuar ndërsa 1214 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Kaçanikut: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara:1474; 1174 nga këto shtëpi janë rindërtuar ndërsa 300 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Kamenicës: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara: 218; 64 nga këto janë rindërtuar ndërsa 154 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Klinës :Nuk ka të dhëna mbi numrin e përgjithshëm të shtëpive të dëmtuara por 350 shtëpi të dëmtuara nuk janë rindërtuar.

Komuna e Lipjanit: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara:1793; 1307 nga këto shtëpi janë rindërtuar ndërsa 486 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Malishevës: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara:6231; 4898 nga këto shtëpi janë rindërtuar ndërsa 3547 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Mitrovicës: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara: 7266; 3719 nga këto janë rindërtuar ndërsa 3547 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Pejës: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara: 3765; 2698 nga këto janë rindërtuar ndërsa 1065 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Podujevës: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara:5350 nga këto shtëpi 4352 janë rindërtuar ndërsa 998 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Prishtinës: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara: 2336, nga këto shtëpi 1337 janë rindërtuar ndërsa 999 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Prizrenit: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara: 3200, nga këto janë rindërtuar 1975 ndërsa 1225 shtëpi nuk janë rindërtuar.

Komuna e Rahovecit: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara: 6449, prej tyre 5145 janë rindërtuar ndërsa 1304 nuk janë rindërtuar.

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

Komuna e Skenderajt: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara: 7305 , prej tyre 4471 janë rindërtuar ndërsa 2834 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Suharekës: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara:9893, prej tyre 5385 janë rindërtuar ndërsa 4508 nuk janë rindërtuar.

Komuna e Vitisë: Nuk ka të dhëna për numrin e përgjithshëm të shtëpive të dëmtuara.

Komuna e Vushtrrisë: Numri i përgjithshëm i shtëpive të dëmtuara:9600; nuk ka të dhëna të sakta se sa shtëpi janë rindërtuar por së paku 1828 shtëpi të kategorisë IV dhe V nuk janë rindërtuar.

MOHIMI

14. Asgjë nga përmbajtja e këtij Raporti nuk duhet nënkuptuar si heqje dorë e Ombudspersonit nga e drejta e tij për të hetuar ankesat e individëve që pohojnë shkeljet e të drejtave të njeriut apo keqpërdorim të autoritetit rreth çështjeve lidhur me Nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Ombudspersoni i rezervon të gjitha të drejtat për të ushtruar juridiksionin e tij lidhur me këto ose çështje tjera të ngjashme të shqyrtuara në këtë raport.

QËLLIMI I RAPORTIT

15. Përqendrimi kryesor i këtij raporti qëndron në konstatimin nëse dështimi i Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës, në nivelin qendror dhe lokal, në përmbushjen e premtimeve të tyre për rindërtimin shtëpive rëndë të dëmtuara apo shkatërruara gjatë luftimit të vitit 1999, është një shkelje e të drejtave të pronarëve të shtëpive e drejtë kjo e mbrojtur me Nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

INSTRUMENTET RELEVANTE

16. Neni 11 i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) (në tekstin e mëposhtëm “ S/RES/1244(1999), në pjesën përkatëse, thotë,

“ Këshilli i Sigurimit [...]

(d) vendos që përgjegjësitë kryesore të prezencës ndërkombëtare në Kosovë do të përfshijnë[...]

(j) mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut [...]

17. Neni 3 i Kapitullit 9 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme të shpallur nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19 të 15 majit 2001 në pjesën përkatëse, thotë:

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

Qeveria Përgjegjësitë e Qeverisë

9.3.1 Qeveria ushtron pushtetin ekzekutiv dhe zbaton ligjet e miratuara nga Kuvendi brenda fushës së përgjegjësisë të institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes të parashtruara në këtë Kornizë Kushtetuese.

9.3.2 Qeveria mund t'i propozoj Kuvendit projektligje me iniciativën e vet dhe me kërkesën e Kuvendit.

Ministritë dhe organet ekzekutive

9.3.3 Ministritë dhe organet ekzekutive themelohen sipas nevojës për kryerjen e funksioneve brenda kompetencave të Qeverisë [...]

18. Përgjegjësitë e Departamentit të Banimit dhe Ndërtimit brenda Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor (është marr prej ueb faqes së qeverisë <http://www.ks-gov.net/mmph>):

Trajton dhe kryen shërbime profesionale dhe legjislativen, realizimin e politikave të Qeverisë së Kosovës në fushën e banimit dhe rindërtimit. Monitoron dhe analizon gjendjen e fushave në kuadër të përgjegjësisë të veta, përgatitë dhe propozon strategjinë, programet dhe masat për përparimin e gjendjes në fushën e banimit dhe ndërtimit dhe siguron realizimin e programeve dhe masave përkatëse, koordinon dhe përgatitë punët profesionale për hartimin e ligjeve dhe rregulloreve dhe monitoron aplikimin e tyre, kryen shërbime analitike, normative, juridike dhe profesionale në fushën e ndërtimit të përcaktuara me Ligjin e Ndërtimit, merr pjesë në realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e banimit dhe ndërtimit si dhe përshtatjen e kornizës ligjore me standardet e Bashkimit Evropian.

19. Neni 2, 3 dhe 4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë (11 gusht 2000) në pjesën përkatëse thotë:

Neni 2 Komunat në Kosovë

2.1 Njësia themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna, e cila ushtron tërë pushtetin, i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për Pushtetin Qendror.

2.2 Komunat rregullojnë dhe udhëheqin çështjet publike në territorin e tyre brenda kufijve të përcaktuar me ligj, për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës. Ato mund të kujdesen për çështje me interes të përgjithshëm që kanë të bëjnë me komunës e tyre cilat nuk i përkasin vetëm pushtetit qendror apo ndonjë organi tjetër.

[...]

2.4. Çdo komunë e ka statusin vetë juridik, të drejtën për të poseduar dhe administruar pronën, mundësinë për të ushtruar padi dhe për të qenë i paditur në gjykata, të drejtën për të lidhur kontrata dhe të drejtën për të marrë punëtorë në punë.

[...]

Neni 3

Përgjegjësitë dhe pushteti i komunave

3.1 Çdo komunë brenda territorit të vetë dhe brenda ligjeve ekzistuese që rregullojnë secilin aktivitet është përgjegjëse për aktivitetet vijuese:

[...]

b) Planifikimin urban dhe të fshatit dhe shfrytëzimin e tokës;

c) Lëshimin e lejeve për ndërtim dhe zhvillime tjera;

d) mbrojtjen lokale të ambientit;

e) Zbatimin e rregullave të ndërtimit dhe kontrollimin e standardeve të ndërtimit;

[...]

Neni i 4

Rregulloret lokale të komunës

4.1 Komunitat mund të nxjerrin rregullore lokale të komunës që i përkasin çështjeve përbrenda kompetencave të komunës. Statuti i komunës duhet të mundësojë kushte për miratimin dhe publikimin e tyre pas konsultimit publik.

20. Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (4 nëntor 1950) (në tekst “Konventa Evropiane për të drejtat dhe lirit e njeriut” ose “Konventa”) në pjesën përkatëse, thotë:

Neni 1 i Protokollit Nr. 1.

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shtetit që të vë në fuqi ligjet që ato i quajnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e të mirave në përshtatje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave, të kontributeve tjera ose të gjobave.

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

ANALIZAT

Nëse dështimi i autoriteteve komunale për të rindërtuar shtëpitë rëndë të dëmtuara ose të shkatërruara, përbënte shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

21. Që nga viti 2004, Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar ankesa të qytetarëve duke pohuar se edhe pse komunat e tyre kishin premtuar se do t'i rindërtonin shtëpitë e tyre të dëmtuara në vitet 1998-99, kjo gjë nuk ndodhi kurrë. Ombudspersoni konsideron se kjo çështje bie nën nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila në pjesën përkatëse thotë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shtetit që të vë në fuqi ligjet që ato i quajnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e të mirave në përshtatje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave, të kontributeve tjera ose të gjobave.”

22. Neni 1 i Protokollit nr. 1 garanton të drejtën për gëzimin e qetë të pronave të individëve dhe në mënyrë të qartë i lejon shtetit të ndërhyj me këtë të drejtë për interesat publike. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, individi mund të pohoj shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 atëherë kur vendimet e vëna në dyshim kanë të bëjnë me “posedimet“ e tij ose saj në kuptim të kësaj dispozite. “Posedimet” mund të jenë ose “posedimet ekzistuese” apo pronat, duke i përfshirë kërkesat, në lidhje me të cilat ankuesi mund të argumentojë se ai ose ajo ka të drejtë të gëzimit efektiv të së drejtës pronësore mbi bazën e besimit legjitim (shih rastin *Kopecky v. Slovakia*, aktvendimi i datës 28 shtator 2004). “Besimi legjitim” duhet të jetë e një natyre më konkrete se sa vetëm një shpresë e thjeshtë, dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore ose në akte ligjore siç është vendimi gjyqësor (shih aktvendimin *Kopecky* të cituar më lartë).

23. Gjatë luftimeve të vitit 1998-99, me dhjetëra mijëra shtëpi u dëmtuan apo u shkatërruan. Sot, gati pothuajse tetë vite më vonë, shumë pronarë të këtyre shtëpive ende janë duke pritur që ato të rindërtohen (për statistika shih parag. 13 më lart).

24. Ombudspersoni vëren që ndonëse autoritetet e tanishme të vendosura nga UNMIK-u nuk ishin në pushtet në kohën kur shtëpitë u dëmtuan apo edhe u shkatërruan, shumica e ankueseve ju thanë përfaqësuesve të Institucionit të Ombudspersonit se kur ata kishin shkuar në komunat e tyre për të kërkuar që shtëpitë e tyre të rindërtohen, komunat iu kishin premtuar se do ti ndërtonin. Në

këtë mënyrë komunat ngritën besim legjitim te pronarët e shtëpive se shtëpitë e tyre do të rindërtoheshin.

25. Ky besim legjitim ishte stimuluar nga fakti se të gjitha komunat mblodhën fakte për dëmet në secilën shtëpi individuale dhe përgatitën lista të përfitueseve të rindërtimit të ardhshëm. Komunat ishin të përfshira plotësisht në tërë procesin; në rastet kur shtëpitë ishin të rindërtuara, ata gjithashtu edhe atëherë ishin pjesë e kontratave të nënshkruara në mes të donatorëve dhe përfituesve.
26. Që nga konflikti i armatosur i vitit 1999, asnjë komunë nuk i kishte refuzuar kërkesat për rindërtim të shtëpive të shkatërruara gjatë konfliktit. Gjithmonë ishte e qartë që në një masë të gjitha shtëpitë e shkatërruara do të rindërtoheshin. Tani, tetë vite me vonë, pronarët e shtëpive që ishin shumë të shkatërruara ose plotësisht të shkatërruara kanë filluar ta pyesin vehten se kur do të jenë në gjendje të kthehen në shtëpitë e tyre. Kjo situatë është acaruar më shumë nga fakti se nga mesi i vitit 2006, shumë nga ata kanë qenë të detyruar ti lëshojnë banesat ose shtëpitë që i kishin zënë në mënyrë jo-ligjore vetëm si alternativë për strehim. Këta njerëz tani e kuptojnë se nuk kanë shtëpi për të jetuar.
27. Ombudspersoni thekson se në rastin *Kirilova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (aktvendimi i datës 9 qershor 2005), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konsideruar se dështimi i shtetit të Bullgarisë për ti ofruar ankuesve të rastit banesa për pronën e tyre të eksproprijuar ishte një shkelje në të drejtat e tyre në gëzimin e pronave të tyre. Po në të njëjtin aktvendim, Gjykata konsideroj se ishte detyrë e autoriteteve publike që të vepronin me kohë, në mënyrë të duhur dhe të qëndrueshme. Gjykata ka vërejtur se autoritetet Bullgare ishin të obliguara që të bashkëpunonin me ankuesit në gjetjen e një zgjidhje të duhur për problemin e tyre. Megjithatë, ndonëse asnjëherë nuk e mohuan se ishin gati për të ndërtuar dhe për të ndarë banesat, ata nuk u treguan të gatshëm për ti ndihmuar ankuesit dhe zgjodhën bile për disa vite edhe ti kundërshtonin në mënyrë aktive përpjekjet e tyre të ndryshme për të kërkuar rivendosje. Një qasje e tillë nuk u konsiderua të jetë në pajtim me obligimet e autoriteteve publike nën Nenin 1 të Protokollit nr. 1. Veç kësaj, Gjykata konsideroj se pohimi për mungesën e fondeve të gatshme për të rindërtuar banesat nuk do të mund ti arsyetonte vonesat e zgjatura në rastin e ankuesve, gjë që llogaritej deri në njëzet vite prej kohës kur ankuesit kishin paraqitur ankesat e tyre në Gjykatë.
28. Rasti në fjalë, edhe pse nuk ka të bëjë me eksproprijim të pronës, ka të bëjë me situatë të njëjtë ku njerëzit ishin të privuar nga e drejta për ti gëzuar pronat e tyre. Ndonëse, organet komunale kompetente nuk ishin përgjegjëse për shkatërrimin e shtëpive të këtyre njerëzve, ata iu kishin premtuar se pronarët e shtëpive do të merrnin një lloj kompensimi. Ky premtim kurrë nuk u mbajt – shumë pronarë të shtëpive rëndë të dëmtuara apo shkatërruara kurrë nuk morën asnjë ndihmë që do tu ndihmonte ti rindërtonin shtëpitë e tyre.

29. Ombudspersoni vëren dhe është i vetëdijshëm për buxhetin e paktë të komunave dhe konsideron se mungesa e mjeteve financiare mund të arsyetojë mos rindërtimin e shtëpive të dëmtuara apo të shkatërruara në vitet menjëherë pas përfundimit të konfliktit të armatosur.
30. Sidoqoftë, ai është gjithashtu i vetëdijshëm për faktin se që nga atëherë, shumica e komunave do të kishin mundur të përfshinin disa forma të ndihmës për rindërtimin e shtëpive në kërkesat e tyre të ndryshme buxhetore bërë nivelit qendror. Megjithatë, shumica e komunave nuk kanë bërë diçka të tillë. Përfshirja e vetëm është me Komunën e Prizrenit, e cila ndau një pjesë të buxhetit të saj vjetor për rindërtimin e shtëpive të shkatërruara gjatë konfliktit të armatosur.
31. Si në rastin *Kirilova* të përmendur më lartë (shih parag. 29 *supra*), Ombudspersoni është i mendimit se për shkak të premtimeve të dhëna pronarëve të shtëpive, komunat përkatëse ishin nën obligimin që të bashkëpunonin me ata për të gjetur një zgjidhje problemit të tyre. Me përjashtim të Komunës së Prizrenit, asnjë komunë e lartpërmendur nuk ndërmori ndonjë veprim të tillë, që përveç ndarjes së pjesës nga buxheti komunalë kanë mund që në mënyrë aktive të përfshijnë edhe autoritetet qendrore ose kërkimin e fondeve të donatorëve ndërkombëtarë për rindërtimin e shtëpive. Arsyetimi për shkak të fondeve të pamjaftueshme nuk e sqaron këtë mungesë të veprimit.
32. Sa i përket udhëheqjes së qeverisë së Kosovës, Ombudspersoni vëren se në bazë të rëndësisë së problemit dhe numrit të madh të njerëzve, shtëpitë e të cilëve ende nuk janë rindërtuar, ka qenë në vartësi të qeverisë për të iniciuar një plan strategjik apo veprues së bashku me komunat për të parë se a janë rindërtuar ato shtëpi. Veçanërisht që kur ka qenë e qartë për një kohë mjaftë të gjatë që shumica e komunave nuk kanë pasur fonde të mjaftueshme për të filluar rindërtimin e shtëpive të shkatërruara, obligimi bie mbi autoritetet qendrore që të interesoheshim për këtë çështje dhe të mundoheshin të gjenin zgjidhje për të gjitha komunat në Kosovë. Në këtë kontekst, Ombudspersoni vëren si gjë shqetësuese faktin se në letrën dërguar Ushtresit të Detyrës së Ombudspersonit më 16 shkurt 2006, përfaqësuesi i zyrës së Kryeministrit deklaroi se vetëm autoritetet lokale ishin përgjegjëse për këtë çështje. Duke mohuar në këtë mënyrë çdo formë të përgjegjësisë në anën e autoriteteve qendrore (shih parag. 16 *supra*).

Konkludim

33. Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Ombudspersoni konkludon se, duke iu premtuar për të rindërtuar këto shtëpi për tetë vite tani, komunat kanë krijuar besim legjitim për pronarët e shtëpive, siç është cekur në rastet tjera para Gjykatës Evropiane për të drejtat e Njeriut. Duke mos ndërmarrë asnjë veprim për të zbatuar premtimet e tyre, komunat në fjalë, me përjashtim të Komunës së Prizrenit, kanë dështuar për të siguruar të drejtën e pronarëve të shtëpive për të gëzuar të drejtën e tyre në pronë, që përbënë shkelje të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

34. Fakti se Qeveria e Kosovës nuk ndërmori asnjë veprim për të mbështetur dhe ndihmuar komunat për të përmbushur obligimet e tyre sipas Konventën përbënë mungesë serioze të përgjegjësisë, në veçanti kur merret parasysh fakti se në gjithë Kosovën njerëzit ankohen se edhe pas tetë viteve pas përfundimit të konfliktit të armatosur më 1999, ata ende nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre. Dështimi për marrjen e përgjegjësisë në lidhje me një çështje të një rëndësie çfarë është kjo, është gjithashtu edhe dështim i qeverisë së Kosovës në përmbushjen e obligimeve që i vihen asaj në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1.

REKOMANDIMET

35. Ombudspersoni rekomandon që komunat e lartpërmendura dhe qeveria e Kosovës do të duhej që, pa ndonjë vonesë të mëtutjeshme:

- Të përgatitin strategjitë se si të sigurohet rindërtimi i shtëpive të mbetura, sidomos të kategoris së pestë, duke përfshirë gjetjen e fondeve të donatorëve ose ndarjen e fondeve të veçanta nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës;
- Të informojë Ombudspersonin për veprimet e ndërmarra si përgjigje në këtë raport, i nxjerr në pajtim me nenin 16.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë.

Hilmi Jashari
Ushtrues Detyre i Ombudspersonit

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!